



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË
VLORE

Nr.1638 Akti
Datë 15.09.2015

Nr.1541 Vendimi
Datë 10.11.2015

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:
GJYQTARE: Gentiana XHELILI (RROKAJ)

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 10.11.2015 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.1638 Akti, që u përket palëve:

PADITËSE: Gentiana Haliti, e bija e Faslli dhe Nirvana, e datelindjes 28.11.1976 lindur dhe banuese ne Lushnje lagja "Skender Libohova" Lushnje.

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, perfaqesuar ne gjykim me autorizimin nr .17822/1 date 28.10.2015 nga Ervisa Shabani.

Me pjesemarrjen ne gjykim te Avokatures se Shtetit Zyra Vendore Vlorë (ne mungese).

OBJEKTI: Pavlefsherine absolute te aktit Administrativ "Njoftim Vleresimi per Detyrimet " nr.13 574 date 24.09.2014.

BAZA LIGJORE: Kodi i Procedures Civil neni 32,153 ,154 324,325 dhe nenin 115 germaC/neni 117 neni 119 Kodi i Procedures Adminitrative. Ligji Nr 9920 dt 19.05.2008 "Per Procedures Tatimore ne Republiken e Shqiperise;

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të ndodhura në dosje, dëgjoi palën paditëse Gentian Haliti, e cila kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesë padisë, dëgjoi palën pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, perfaqesuesen e saj Ervisa Shabani e cila kerkoi nga gjykata rrezimi e kërkesë padisë, pala pjesëmarrëse ne proces Avokaturës se Shtetit Zyra Vendore Vlore nuk u dëgjua ne këtë gjykim pasi ishte në mungesë me gjithë dijeninë e rregullt qe kishte per procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se paditësi Gentiana Haliti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me një kërkesë padi me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ne baze të nenit 12 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

Rrethanat e faktit

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësja Gentiana Haliti është regjistruar si subjekt fizik e pajisur me nr. NUIS K94608401C, me adresë Lagja "Çlirimi", godine një kateshe, Lushnje, me objekt veprimtarie "Veprimtari Juridike".

Rezulton se në datë 12.06.2014 nga inspektorët e palës së paditur është ushtruar kontroll ku është mbajtur akti i konstatimit me nr.0422947 datë 12.06.2014.

Mbi akt konstatimit me nr.0422947 datë 12.06.2014 nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është nxjerr njoftim vleresimit me nr.13574 datë 24.09.2014 për paditësen Gentian Haliti duke bërë përlogaritjen e detyrimit tatimor për periudhën e mos deklarimi vite 2011 deri në vitin 2014.

Paditësja pasi ka marrë dijeni për njoftim vleresimin nr.13574 datë 24.09.2014 ka ushtruar ankim ndaj tij në datë 14.10.2014 pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimeve Tirane.

Nga Drejtoria e Apelit Tatimor Tirane me shkresën me nr. 28077/1 prot datë 13.01.2015 është vendosur refuzimi i ankimit të ushtruar ndaj njoftim vleresimit për detyrimet tatimore me nr. 13574 prot datë 24.09.2014 të nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier".

Paditësja Gentiana Haliti duke mos qenë dakort me njoftim vleresimin nr.13574 datë 24.09.2014, i është drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;

Së pari; paditësja në vitin 2010 e në vazhdim e ka pezulluar aktivitetin në Q.K.R, për arsye të rënda shëndetësore, sic rezulton edhe nga epikriza e lëshuar nga mjeku.

Në momentin që është mbajtur akti i konstatimit, paditësja ka qenë në tentativë për tu regjistruar në subjektin Avokat Enea Salati, pasi ajo vet nuk ishte e aftë të punonte e vetme, prandaj ky akt konstatimi i është bërë paditëses me tendencë për ta gjobitur atë, duke shkelur rregullat administrative pasi akti është nxjerre në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Së dyti; organi ka kapercyer kompetencat ligjore, pasi në rastin konkret kontrolli i ushtruar është kryer duke kapercyer kompetencat territorial nga grupi i kontrollit, pasi kanë ushtruar kontroll në juridiksionin e D.R.T.Fier dhe nuk kanë qenë të shoqëruar nga asnjë përfaqësues të

D.R.T.Fier, ku paditesja e ka pezulluar aktivitetin dhe se zyra ka qene e mbyllur.

Së treti; ne nenin 117 te K.Pr. Administrative theksohet se secila pale e interesuar mund te kerkoje qe akti administrative te shpallet "*absolutisht i pavlefshem*" dhe se kerkesa ne fjale mund te behet ne cdo kohe.

Paditesja e bazon pretendimin e saj per pavlefshmerine e aktit adminitrativ "*njoftim vleresimi per detyrimet*" me nr.13574 date 24.09.2014, sipas references dhe arsytimit ligjor te siper permendur.

Për sa me sipër paditësja Gentiana Haliti kërkoj nga gjykata pranimin e kërkesë padisë si te bazuar ne ligj dhe ne prova.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me ane te perfaqesueses se saj Ervisa Shabani ka prapësuar ne gjykim se;

Së pari; paditesja Gentiana Haliti eshte regjistruar si subjekt fizik me nr.K94608401C NUIS, me adrese Lagja Clirimi, godine nje kateshe, Lushnje, me objekt veprimtarie "Veprimtari Juridike".

Ne zbatim te urdhrit te punes nr.9114 date 12.06.2014 te dale ne zbatim te ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "*Per Procedurat Tatimore te Republikes se Shqiperise*" neni 80.3 germa C, si dhe te udhezimit nr.24 date 02.09.2008 ne zbatim te tij, inspektoret e verifikimit ne terren, prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, kane ushtruar kontroll ne subjektin Gentian Haliti me NIPT K94608401C, e cila eshte gjetur ne pune.

Nisur nga fakti i mesiperm nga inspektoret e verifikimit ne terren eshte mbajtur akt konstatimin me nr.0422947, ne te cilin eshte konfirmuar fakti se subjekti i mesiperm ushton aktivitetet dhe eshte gjetur ne pune Znj. Gentiana Haliti.

Nisur nga rrethanat e mesiperme, ne zbatim te nenit 71 te ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "*Per Procedurat Tatimore te Republikes se Shqiperise*" referuar akt konstatimit nr.0422947, subjektit Gentiana Haliti me NUIS K94608401C i eshte bere vleresim nga zyra per te gjithë periudhen e mos deklarimit.

Ky fakt dhe detyrimet e rrjedhura si pasoje e vleresimit nga zyra, tatimpaguesit te mesiperm i jane komunikuar me njoftim vleresimin per detyrimet tatimore nr.13574 date 24.09.2014.

Së dyti; referuar pretendimeve te Zj. Gentiana Haliti se ne vitin 2010 ka bere pezullim ne QKR, dhe se Akt Konstatimi eshte bere me tendence per ta gjobitur, ne tejkalim te juridiksionit territorial, dhe ne kundershtrim me formen dhe proceduren ligjore, nuk qendrojne.

Ne zbatim te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "*Per Procedurat Tatimore te Republikes se Shqiperise*",subjektit i cili ka bere pezullim aktiviteti, supozohet qe nuk ushtron aktivitetet dhe duhet te dorezoj deklaratat me zero, sipas pergjegjesive tatimore me te cilat eshte i klikuar Znj.Gentiana Haliti ne sitemin informatik te Tatimeve figuron mosdeklarues qe nga marsi i vitit 2011. Gjithashtu rezulton se subjekti Gentiana Haliti, duke qene se ka bere pezullim aktiviteti, nuk duhet te ushtronte aktivitetet, deri ne ndryshimin e statusit te saj ne QKR, nga i pezulluar ne aktiv.

Së treti: në lidhje me pretendimin e pales paditese se kontrolli i ushtruar është bere ne kapercim te kompetencave territoriale, dhe se grupi i kontrollit nuk ka qene i shoqeruar nga asnje perfaqesues i DRT Fier, nuk mund te provohet me asnje dokument shkresor dhe nuk ka baze ligjore. DRT Fier është kopetente per ushtrimin e kontrollit ne cdo subjekt i cili ushtron aktivitet ne territorin e administruar prej saj, i cili perfshin gjithë Qarkun e Fierit.

Kontrolli i ushtruar, është bere ne zbatim te urdherit te punes nr.9114 date 12.06.2014 te D.R.T Fier, nga inspektoret Tasim Rakipi dhe Endrit Latifaj, te cilet sic shprehet edhe ne urdherin e punes, jane punonjes prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, me detyre inspektor te verifikimit ne terren. Akt konstatimi me nr.0422947 është konform klauzolave te parshikuara ne ligjin nr.9920 "Per Procedurat Tatimore" dhe sa me siper referuar legjislacionit dhe provave, nuk ndodhemi ne rrethanat e pavlefshmerise absolute te parashikuara ne nenin 116 te Kodit te Procedurave Administrative, pasi akt konstatimi është konform ligjit persa i perket, formes, procedures dhe kompetencave, edhe njoftim vleresimi nr.13574 date 24.09.2014 i dale ne zbatim te tije është teresisht ligjor dhe i vlefshem.

Për sa me sipër pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nepermjet perfaqesuese se saj Ervisa Shabani kërkoi nga gjykata rrezimin e kërkesë padisë si e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Pala e pjesëmarrëse ne gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlore nuk u dëgjua pasi është vijuar gjykimi ne mungese me gjithë njoftimin e rregullt qe kishte për procesin gjyqësor dhe nuk ka depozituar prapësime me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore te kësaj gjykate.

Gjykata pasi ka administruar provat dhe ka analizuar në tërësi çështjen, çmon se kërkesë padia e paraqitur nga paditesja Gentiana Haliti është e bazuar ne ligj e prova dhe si e tille do te pranohet.

Arsyetimi ligjor

Në nenin 7, pika a të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Gjykata administrative janë kompetente për; a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontrata administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga organi publik.

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se ;Të drejtën e padisë e ka: a) cdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Ne nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

parashikohet se: *Padia ngrihet;*

c) *per konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ'*

Rezulton se pala paditëse Gentjana Haliti ka një interes legjitim për të kërkuar konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet Tatimore nxjerrë nga pala e paditur.

Rezulton se pala paditëse i është drejtuar gjykatës me objekt pavlefshmëri absolute të aktit administrativ.

Pavlefshmëria absolute e një akti administrativ është parashikuar në nenin 116 të K.Pr.Administrative sipas të cilit ' *Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në kuptimin e këtij Kodi në rastet e mëposhtme;*

a) *kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;*

b) *kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;*

c) **akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.**

Që të jemi para një akti absolutisht të pavlefshëm duhet që akti të jetë nxjerrë në një nga kushtet e mësipërme.

Se pari: Rezulton se vendimi nr.13574 prot, date 24.09.2014 i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Fier është nxjerrë nga një organ i identifikuar që është Dega e Tatimeve Fier.

Se dyti: Rezulton se akti administrativ nuk është nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore pasi në zbatim të Ligjit 'Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise' Deget Rajonale te Tatimeve kanë të drejtë të nxjerrin akte administrative gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Se treti: Përsa i perket formës dhe procedurës, gjykata çmon se akti administrativ ka dale në kundërshtim me formën dhe procedurën, pasi akt-konstatimi i mbajtur nuk eshte i qarte dhe i arsyetuar dhe per kete arsye edhe njoftimi vleresimi per detyrimet tatimore i Drejtorise se Tatimeve Fier eshte nja akt administrativ ne kundërshtim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga Ligji 'Për Procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë' dhe Udhezimi nr.24, date 02.09.2008 'Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise'

Ne nenin 80 te ketij udhezimi parashikohet kontrolli tatimor ku ne piken 80.3/b te tij percaktohet se kur mund te kryhen verifikimet ne vend dhe konkretisht parashikohet se '*verifikimet ne vend synojne zbulimin e shpejte te shkeljeve qe kane lidhje me rregjistrimin e personave te tatueshem, identifikimin e personave te parregjistruar, me dokumentimin e shitjeve dhe leshimin e faturave tatimore etj.*

Procedurat teknike te detajuara per kryerjen e nje kontrolli tatimor percaktohen ne Manualin e kontrollit tatimor.

Ne piken 83 te Udhezimit parashikohet se çfare duhet te permbaje nje raport kontroll dhe koncretisht "83.1 Pas çdo kontrolli tatimor, jo me shume se shtate dite nga përfundimi i tij, inspektori i kontrollit tatimor, është i detyruar te

përgatisë raportin e kontrollit. 83.2 Raporti i kontrollit tatimor, përshkruan veprimtarinë ekonomike e tregtare të personit të tatueshëm, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, të dhënat e shfrytëzuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështet atë. Raporti i kontrollit përbën bazën për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrole të mëvonshme si dhe për vlerësimin e punës së vete kontrollorit nga ana e drejtuesve të drejtorisë rajonale të tatimeve. 83.3 Inspektori i kontrollit i jep urdhëruesit të kontrollit një kopje të raportit të kontrollit, kurse një kopje tjetër ia dërgon personit të tatueshëm, me shërbimin postar rekomandë.

83.4 Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

83.5 Kundërshtimi paraqitet me shkrim dhe ai i dërgohet drejtorisë rajonale të tatimeve me shërbimin postar rekomandë ose dorëzohet dorazi në drejtorinë rajonale përkundërt marrjes së një konfirmimi me shkrim. 83.6 Inspektori/inspektoret e kontrollit tatimor, në bashkëpunim me eprorin direkt, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kundërshtimit të personit të tatueshëm, shqyrtojnë kundërshtimin e paraqitur dhe japin gjykimin e tyre për të, gjykim të cilin e përfshijnë në projektin e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor. Për shembull, në qoftë se raporti i kontrollit tatimor është marrë nga ana e personit të tatueshëm nëpërmjet shërbimit postar rekomandë në datën 5 të një muaji, personi i tatueshëm deri me datë 10 të muajit duhet të dërgojë kundërshtimin e tij, nëpërmjet shërbimit postar rekomandë, në adresën e drejtorisë rajonale të tatimeve. Duke supozuar që drejtoria rajonale e tatimeve e ka marrë kundërshtimin në datën 15 të muajit, inspektori/inspektoret e kontrollit do të kenë 5 ditë pune kohe për të shqyrtuar kundërshtimin e personit të tatueshëm, për të dhënë gjykimin e tyre për kundërshtimin dhe se fundi për ta përfshirë këtë gjykim në projektin e raportit përfundimtar të kontrollit.

Nuk rezulton që akt-kontrolli i datës 12.06.2014 të ketë përshkruar deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, të dhënat e shfrytëzuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështet atë. Raporti i kontrollit përbën bazën për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrole të mëvonshme si dhe për vlerësimin e punës së vete kontrollorit nga ana e drejtuesve të drejtorisë rajonale të tatimeve.

Pra nuk rezulton që inspektoret tatimore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier të kenë përshkruar se çfarë po kryente paditesja në momentin e kontrollit, nëse po ofronte asistencë juridike, janë gjetur apo jo kliente që të krijonin dyshime se paditesja ushtronte aktivitetin e saj si avokate dhe gjithashtu dhe nga vete kontrolli nuk rezulton që të jete propozuar në këtë akt-kontroll shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat ligjore.

Pra nuk rezulton që grupi i kontrollit të ketë respektuar procedurën e kërkuar

nga ligji dhe për këtë arsye akt-kontrolli i datës 12.06.2014 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier është absolutisht i pavlefshëm.

Po kështu dhe njoftim vlerësimi me nr.13574 prot, datë 24.09.2015 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm pasi ka dalë mbi një akt-kontroll absolutisht të pavlefshëm.

Sa më sipër, gjykata çmon se jemi para një akti absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 116/c të K.Pr.Administrative.

Sa më sipër, gjykata çmon se kërkesë padia duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 **"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"**, nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesë-padisë.
2. Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet" me nr.13574 datë 24.09.2014 nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për subjektin Gentiana Haliti.
3. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
4. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë.

U shpall sot në Vlorë me datë 10.11.2015

SEKRETARE

Edlira SHEHU

GJYQTARE

Gentiana XHELIL (RROKAJ)

SHPENZIMET GJYQËSORE

Taksa e regjistrimit padie 3000 (tre mijë) leke
TOTALI 3000 (tre mijë) leke

Vendimi mori formë të protës

Solme datë 10/11/2015

KANCERET TAVELI MYFTARI